



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Nr. 1652 prot

Tiranë më 22.5.2020

## LETËR E HAPUR PUBLIKE

**Drejtuar: Personelit akademik dhe studentëve të Universitetit të Tiranës**

**Për dijeni: Kryeministrit, z.Edi Rama**

**Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj.Besa Shahini**

**Të nderuar kolege të Universitetit të Tiranës,**

**Të dashur studentë të Universitetit të Tiranës**

Jam informuar në rrugë informale që në datën 21 maj 2020, është zhvilluar një pseudombledhje, në Godinën "Liria", nga një grup senatorësh të Senatit Akademik të UT.

Në lidhje me këtë pseudombledhje të zhvilluar prej tyre, dua t'ju sqaroj se:

Në datën 14 maj 2020, nëpërmjet email-it, jam njohur me kërkesën që më është paraqitur, në cilësinë e Kryetarit të Senatit Akademik të UT, nga senatori, z.Artur Sula, për zhvillimin e një mbledhje Senati, dhe kishte përcaktuar rendin e ditës, datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohej kjo mbledhje.

Kërkesa e z.Artur Sula, u përkrah edhe nga një numër i caktuar senatorësh.

Pasi u njoha me këtë kërkesë, me shkresën nr. 1639 datë 20.05.2020, drejtuar të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik (bashkëngjitur), i kam sqaruar hollësisht, me nene dhe ligje konkrete, arsyet se përse kërkesa e paraqitur nga z.A.Sula, **nuk ishte aspak kompetencë e Senatit Akademik.**

Z.Artur Sula kërkonte të vendosej mbi: *“Qëndrimin e Senatit Akademik të UT për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës për pesë pedagogë të UT dhe diskutimi për statusin dhe marrëdhëniet e punës për personelin akademik të UT”*.

Sigurisht që kjo çështje nuk është aspak kompetencë e Senatit Akademik.

Në fakt, me veprimet e fundit, u vërtetua edhe një herë katërcipërsisht se cilët janë autorët, bashkëautorët dhe mbështetësit e situatës të paprecedente të krijuar së fundmi në Universitetin e Tiranës, në lidhje me pseudoprocesin zgjedhor që pretendojnë që është hapur në UT, duke u përpjekur ta paraqesin si një proces zgjedhor të ligjshëm për autoritetet drejtuese dhe për anëtarë të Senatit Akademik të UT.

Ky proces i paligjshëm, është mbështetur hapur nga autoritetet drejtuese të fakulteteve të Universitetit të Tiranës, Dhori Kule, Artan Hoxha, Artur Sula, Edmond Rapti, të cilët, edhe pse janë informuar nga Rektori mbi shkeljet flagrante të ish anëtarëve të KIZ (bashkëngjitur shkresa e Rektorit nr.1554 datë 30.04.2020 drejtuar të gjithë dekanëve të fakulteteve të UT), dhe ju është kërkuar të mos kryenin asnjë veprim në lidhje me dokumentat e nxjerra prej tyre, ata kanë vazhduar t’i mbështesin, kanë shpërndarë materialet e tyre nëpërmjet adresave zyrtare të email-eve; i kanë publikuar në faqet zyrtare të njësive kryesore që ato drejtojnë dhe për më tepër, kanë aplikuar për autoritete drejtuese apo anëtarë të Senatit Akademik të UT në këtë proces të paligjshëm zgjedhor, duke u bërë kështu palë në këtë paligjshmëri.

Lehtësisht është e kuptueshme se këto veprime, këta persona i kryejnë vetëm për të ruajtur pozicionet e tyre drejtuese, duke mos dashur të zhvillohet në proces ligjor i ligjshëm, me një garë të vërtetë dhe të ndershme midis kandidatëve.

Kjo nuk tregon gjë tjetër veçse pasigurinë dhe frikën e tyre, për të marrë pjesë në një garë të ndershme, sipas ligjit dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Zgjedhjeve të UT.

Janë pikërisht këta persona që me porositë apo urdhërat e tyre, mësuhan, drejtuan apo detyruan edhe këta 5 (pesë) ish personel akademik të UT, kontratat e punës të të cilëve, i janë ndërprerë në mënyrë të menjëhershme, për arsye të justifikuar, nga Rektori i UT, si autoriteti drejtues më i lartë akademik në institucion, që ligji i arsimit të lartë 80/2015, në nenin 39, pika 5 të tij, i ka dhënë kompetencën e nënshkrimit të kontratave të punës me personelin akademik, dhe jo vetëm.

Tashmë është e qartë që: Dhori Kule, Artan Hoxha, Artur Sula dhe Edmond Rapti, prej 4(katër) vitesh, në mënyrë të përsëritur, në shkelje flagrante të ligjit të arsimit të lartë 80/2015 dhe të shumë akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi; të mbështetura edhe nga Bordi i Administrimit dhe Administratori i UT, kanë përdorur të gjitha rrugët dhe metodat për të penguar funksionimin normal të institucionit të Universitetit të Tiranës.

Këta persona, në këto vite, janë përkrahur dhe mbështetur edhe nga një grup i caktuar senatorësh, të cilët, edhe në rastin e fundit, kanë pseudoaplikuar për të qenë përsëri anëtarë të Senatit Akademik të UT, në një proces të paligjshëm zgjedhor, duke shpërdoruar në këtë mënyrë besimin dhe votën tuaj.

Edhe në këtë rast, në shkelje flagrante të ligjit nr.8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, organizuan edhe këtë pseudombledhje të paligjshme. **Si rrjedhim, edhe çdo akt apo dokument i nxjerrë prej tyre, është absolutisht i paligjshëm, është nul dhe i pazbatueshëm.**

Këta anëtarë të Senatit Akademik, sipas informacionit verbal që kam, paskërkan marrë në shqyrtim, analizuar dhe shfuqizuar Vendimet e Rektorit mbi çështjen e marrëdhënies të punës me personelin akademik, që siç dihet, janë tërësisht kompetencë vetëm e Rektorit.

Dhe kjo duket qartë në pikën 1 të pseudovendimit të tyre, duke pretenduar se sipas tyre “*Senati Akademik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve apo vendimeve të Rektorit*”, duke pretenduar se Senati Akademik qenkërka “*eprori*” i Rektorit.....

Kjo është sa qesharake, por edhe po aq e paligjshme.

Senati Akademik është organi kolegjial më i lartë drejtues në UT, por Rektori është autoriteti akademik më i lartë drejtues në UT. Ligji i arsimit të lartë 80/2015, i ka përcaktuar qartë dhe i ka ndarë kompetencat e tyre.

Rektori nuk ka varësi funksionale dhe nuk është nomenklaturë e Senatit Akademik. Ai zgjidhet nga personeli akademik dhe studentët me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës dhe dekretohet me Dekret të veçantë të Presidentit të Republikës.

Në referim të nenit 153 pika 3 të Kodit të Punës, **Gjykata është organi kompetent që bën vlerësimin e shkaqeve të justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënies së punës dhe jo Senati Akademik.**

Lehtësisht është e kuptueshme se me këto veprime, në fakt ata kërkojnë të legjitimojnë të ashtuquajturin “proces zgjedhor” në UT; të legjitimojnë pseudoaplikimet që kanë bërë për autoritete drejtuese apo anëtarë të Senatit Akademik të UT, në një proces zgjedhor të paligjshëm sepse, siç e dini, procesi nuk është shpallur akoma nga Rektori i UT (shiko nenin 5 pika 3 të Rregullores së Zgjedhjeve të UT) dhe brenda 3(tri) ditësh nga shpallja e këtij procesi zgjedhor nga Rektori, Senati Akademik, ka detyrimin ligjor të miratojë Komisionin Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) të UT (shiko nenin 6, pika 1 , gërma a) të Rregullores së Zgjedhjeve të UT).

Pra, këta persona kërkojnë të legjitimojnë edhe një komision zgjedhor institucional (KIZ) të paligjshëm, mandati i të cilit ka përfunduar qysh me miratimin e Rregullores së Zgjedhjeve të UT, për më tepër, me anëtarë ish personelin akademik të UT, të cilëve ju është zgjidhur kontrata e punës me Universitetin e Tiranës, në mënyrë të menjëhershme, për shkaqe të justifikuara, nga Rektori i UT, qysh në datën 6 maj 2020.

Kjo duket qartë në pikën 2 të pseudovendimit të tyre, kur në mënyrë skandaloze, vendosin ata se kur do të miratohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) i UT, duke shkelur në këtë mënyrë Rregulloren e Zgjedhjeve të UT, të miratuar nga vetë ata, dhe duke përdorur lloj lloj artificash dhe argumentash të paqëna, për ta bërë të mundur këtë gjë.

Në të njëjtën mënyrë, të njëjtët persona, aktualisht autoritete drejtuese në njësitë kryesore (fakultetet) e UT, kanë përdorur edhe komisionet zgjedhore të fakulteteve përkatëse (KZF), të cilët gjithashtu janë të paligjshëm dhe me mandate të përfunduara, sepse këto komisione ngrihen pas miratimit të KIZ –it (shiko nenin 7, pika 1 të Rregullores së Zgjedhjeve të UT), përjashtuar pedagogët, ish anëtarë të KZF të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar të UT.

Të gjithë pedagogët, në cilësinë e ish anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore të fakulteteve (KZF), me veprimet që kanë kryer, janë në shpërdorim detyre, në tejkalim kompetencash, dhe janë në shkelje flagrante të Rregullores së Zgjedhjeve të UT.

Sikurse ju kam sqaruar edhe në komunikimet e mëparshme në lidhje me këtë çështje (bashkëngjitur) shkresa nr.491 datë 24.01.2020), janë të njëjtët persona që përpiqen të pengojnë funksionimin normal të institucionit; që përpiqen të drejtojnë institucionin, përpiqen të drejtojnë organin kolegjal, Senatit Akademik dhe në çdo rast, keqinterpretojnë ligjin dhe tjetërsojnë të vërtetën absolute.

**Të nderuar kolegë,**

**Të dashur studentë,**

Edhe një herë do të kërkoja nga ana juaj, të konsultoheshit me Rregulloren e Zgjedhjeve të UT, për të kuptuar edhe më mirë të gjitha sa më sipër ju sqarova, por edhe për të njohur edhe më mirë të gjithë procesin zgjedhor dhe të gjitha procedurat që duhet të kryhen menjëherë pas shpalljes së këtij procesi zgjedhor nga titullari më i lartë akademik i institucionit, Rektori i UT.

Sikurse e kam theksuar, sapo Ministri përgjegjës për arsimin, të caktojë datën e fillimit të procesit zgjedhor dhe ditën e zgjedhjeve, Rektori i UT, në mënyrë të menjëhershme, në zbatim të detyrimeve ligjore sipas nenit 5, pika 3 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës”, të miratuar me Vendimin nr.5 datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, do të shpallë Urdhërin për ditën e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të UT.

Do të kërkoja të vlerësonit maksimalisht procesin zgjedhor që do të zhvillohet në UT, si një proces kaq të rëndësishëm për institucionin; të jeni aktiv në këtë proces, edhe duke aplikuar për autoritete drejtuese dhe anëtarë të Senatit Akademik të UT, edhe duke marrë pjesë gjerësisht në procesin e votimit, për të sjellë në këtë mënyrë, frymë dhe mendësi të re në institucion.

Ju siguroj se, në cilësinë e Rektorit të UT, do të bëj të gjitha përpjekjet ligjore dhe institucionale, me qëllim që në Universitetin e Tiranës, të zhvillohet një proces zgjedhor i ligjshëm, transparent dhe gjithëpërfshirës.

**REKTORI**  
**PROF.DR.MYNYR KONA**



---

Adresa: Sheshi “Nënë Tereza” Rektorati i UT, Tiranë, Tel: +355 4 22 36 8402 / Fax: +355 4 22 39 81



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK  
KRYETARI

Nr. 1639 Prot.

Tiranë, 10.05. 2020

Lënda: Kthim përgjigje mbi kërkesën e senatorit, z.Artur Sula

**Drejtuar: Të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik të UT**

Të nderuar Senatorë,

Nëpërmjet email-it, jam njohur me kërkesën që më është paraqitur, në cilësinë e Kryetarit të Senatit Akademik të UT, nga senatori, z.Artur Sula.

Sikurse jeni njohur edhe ju, nga z.Artur Sula, është kërkuar zhvillimi i një mbledhje Senati, duke përcaktuar rendin e ditës, datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet kjo mbledhje.

Në ligjin nr.8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, në nenin 6 të tij, “Thirrja e mbledhjeve”, përcaktohet se:

1. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhje kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.
2. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, të paktën 48 orë para datës së thirrjes së mbledhjes.

Dhe në nenin 7 të ligjit të sipërcituar, “Rendi i ditës”, përcaktohet se:

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj (në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, nuk është parashikuar ndryshe), kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë propozuar atij nga anëtarët e organit kolegjial me të drejtë vote dhe që janë në kompetencë të këtij organi.....

Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga Z. Sula “Qëndrimi i Senatit Akademik të UT për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës për pesë pedagogë të UT dhe diskutimi për statusin dhe marrëdhëniet e punës për personelin akademik të UT”, theksoj se çështja në fjalë, **nuk është aspak kompetencë e Senatit Akademik.**

Kjo për arsye se:

Zgjidhja e menjëhershme për shkaqe të arsyeshme, e marrëdhënieve të punës me Universitetin e Tiranës, për 5 (pesë) ish personelin akademik, nuk janë aspak kompetencë e Senatit Akademik, as për t'u analizuar, as për t'u shqyrtuar, apo për t'u "mbajtur një qëndrim" nga Senati Akademik i UT.

Sikurse mund të jeni njohur me Vendimet përkatëse, për zgjidhjen e menjëhershme, të justifikuar, të marrëdhënieve të punës për 5(pesë) ish personelin akademik të UT, Rektori është bazuar në nene të caktuara të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, mbi bazën e të cilit ngrihen dhe funksionojnë marrëdhëniet e punës në UT; në nenin 39, pika 5 të ligjit të arsimit të lartë 80/2015 dhe në nenin 34, pika 1, gërma b) të Statutit të UT, në të cilat, është përcaktuar shumë qartë se Rektori është autoriteti më i lartë drejtues akademik në institucionin publik të arsimit të lartë (dhe sigurisht edhe në Universitetin e Tiranës), që nënshkruan kontratat e punës me personelin akademik, dhe jo vetëm.

Dhe në zbatim të nenit 12 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, **kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve.**

Në rastin konkret, Rektori që nënshkruan kontratat e punës me personelin akademik, është punëdhënësi dhe personeli akademik përkatës, është punëmarrësi.

Zgjidhja e kontratës së punës me 5–ish personel akademik i UT-së është bazuar tek ligji material që rregullon marrëdhënien e punës që është Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht neni 153 i tij, që ka të bëjë me zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës për shkaqe të justifikuara.

#### *Neni 153 Shkaqe të justifikuara*

*1. Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.*

*2. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.*

*3. Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.*

Rektori në cilësinë e punëdhënësit ka vlerësuar se shkaqet janë të justifikuara dhe ka zgjidhur menjëherë kontratën (këto shkaqe janë evidentuar në vendimet përkatëse të largimit për secilin ish personel akademik).

Në referim të nenit 153 pika 3 të Kodit të Punës, Gjykata është organi kompetent që bën vlerësimin e shkaqeve të justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënies së punës dhe jo Senati Akademik.

Në asnjë rast, këto Vendime të Rektorit, nuk janë mbështetur në nenin 68 të ligjit të arsimit të lartë 80/2015 dhe në nenin 76, pika 4 të Statutit të UT, nene këto aq shumë të përfolura dhe të

keqinterpretuara nga drejtuesit e njësive kryesore, pjesë e të cilave kanë qenë 5(pesë) ish personeli akademik, të shprehura në shkresat e tyre zyrtare, të përcjella në Rektorat.

Neni 68, pika 2 e ligjit të arsimit të lartë 80/2015, bën fjalë vetëm për rastet kur drejtuesi i njësisë bazë, ku personeli akademik bën pjesë, propozon për dhënien e masës disiplinore për largim nga puna, për arsye të shkeljeve të rënda që lidhen me veprimtarinë e tij në departament.

Në fakt, arsyet për zgjidhjen e menjëhershme, të justifikuar të marrëdhënieve të punës për 5(pesë) ish personelin akademik të UT, janë krejtësisht të tjera dhe nuk kanë asnjë lidhje me autoritetin drejtues të njësisë bazë, pjesë e të cilës ka qenë secili prej 5(pesë) ish personelit akademik.

Arsyet e zgjidhjeve të menjëhershme, të justifikuara të marrëdhënieve të tyre të punës me UT, janë të renditura, të arsyetuara qartë dhe të konkretizuara me nene, ligje dhe akte ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të cilat, personat në fjalë, kanë kryer shkelje në mënyrë flagrante.

Të nderuar senatorë,

Vendimet e Rektorit për zgjidhjen e menjëhershme, të justifikuar të marrëdhënieve të punës të 5(pesë) ish personelit akademik të UT, nuk janë as të paligjshme, as jashtë kompetencave të Rektorit, as nul, dhe, për më tepër, as të nxituara.

Për sa i përket komentit të bërë nga disa prej jush se “*këto vendime qenkërkan të nxituara*”, do të ishte mirë të ishit njohur me vendimet e Rektorit dhe do të kuptonit se palishgjëmëria e tyre arriti kulmin, kur këta persona, në kohën e pandemisë të shkaktuar nga virusi Covid 19, shkelën në mënyrë flagrante aktet e nxjerra nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave për gjendjen e fatkeqësisë natyrore; shkelën urdhërat e nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë, deri në përfundimin e pandemisë të shkaktuar nga virusi Covid 19.

Ata shkelën ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe Rregulloren e Zgjedhjeve të UT, të miratuar me Vendimin nr.5 datë 10.02.2020 të këtij Senati Akademik; morën kompetencat dhe rolin e titullarit më të lartë të institucionit që është Rektori i UT, dhe të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve të UT, për zgjedhjet për autoritete drejtuese dhe anëtarë të Senatit Akademik të UT, për vitet 2020-2024, që në fakt nuk është zgjedhur dhe miratuar akoma (shiko nenin 6, pika 1, gërma a) të Rregullores së Zgjedhjeve të UT), duke përgatitur, firmosur dhe dërguar me email, edhe në formë shkresore dokumenta, të cilat ishin në shkelje flagrante të Rregullores së sipërcituar. Duke shkaktuar në këtë mënyrë kaos në rradhët e personelit akademik dhe të studentëve që kërkojnë të kandidojnë për autoritete drejtuese apo anëtarë të Senatit Akademik të UT, desinformim të tyre dhe të mbarë opinionit publik, me deklaratat apo daljet që bënin nëpër media.

Prandaj, kërkesa e z.Artur Sula, e mbështetur edhe nga disa prej jush, **nuk është aspak kompetencë e Senatit Akademik.**

Në përfundim, theksoj edhe një herë se Vendimet e Rektorit për zgjidhjen e menjëhershme, të justifikuar të marrëdhënieve të punës të 5 (pesë) ish personelit akademik të UT, janë të ligjshme,

brenda kompetencave ligjore që ka Rektori dhe të detyrueshme për t'u zbatuar nga strukturat përkatëse.

Vendimet e Rektorit, i janë përcjellë zyrtarisht për njohje personave përkatës dhe për zbatim autoriteteve drejtuese të njësive kryesore, autoriteteve drejtuese të njësive bazë përkatëse, administratorëve të njësive kryesore ku këta persona kanë bërë pjesë deri në momentin e ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës si dhe Administratorit të UT.

Asnjë autoritet apo organ drejtues në institucion, nuk ka të drejtë apo kompetencë ligjore, as të analizojë, as të interpretojë dhe as të mos zbatojë Vendimet e Rektorit, të marra në zbatim të kompetencave të tij ligjore.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**PROF.DR. MYNYR KONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Nr. 1554 Prot.

Tiranë, 30. 4. 2020

**Lënda:** Mbi veprimet e paligjshme, me pasoja për Universitetin e Tiranës, të ish anëtarëve të KIZ të UT

**Drejtuar:** Të gjithë Dekanëve të Fakulteteve të UT

Jam njohur në rrugë jozyrtare me disa dokumenta të firmosura nga ish anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve të UT, me të cilat, besoj se jeni njohur edhe ju.

Në lidhje me këto dokumenta, ju sqaroj se:

**Së pari**, ish anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve të UT, janë zgjedhur në këtë detyrë nga Senati Akademik me Vendimin nr.8 datë 21.03.2016 të Senatit Akademik të UT, në zbatim të nenit 6, pika 1, gërma a të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të parapër autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në RSH", me nr.2459/4 prot, datë 15.03.2016 të Ministrit të Arsimit,, Sportit dhe Rinisë, tashmë të shfuqizuar.

**Së dyti**, në zbatim të nenit 26 të Rregullores së sipërcituar, në të cilën theksohet se **mandati i anëtarëve të KIZ, është 4 (katër) vjecar**, ish anëtarëve të KIZ i ka përfunduar mandati dhe tashmë, ata janë vetëm ish anëtarë të një prej komisioneve të shumta institucionale zgjedhore që ka patur në gjithë këto vite në Universitetin e Tiranës.

**Së treti**, sikurse e dini, në Universitetin e Tiranës, me Vendimin nr.5 datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, është miratuar Rregullorja "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës" dhe sigurisht, të gjitha procedurat që do të ndiqen për realizimin e një procesi zgjedhor të ligjshëm për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe anëtarëve të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, do të bazohen dhe do të mbështeten vetëm tek kjo Rregullore e Zgjedhjeve, në ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe në aktet e tjera në fuqi në lidhje me këtë proces kaq të rëndësishëm për institucionin.

Në këto kushte, të gjitha dokumentat e firmosura nga ish anëtarët e KIZ janë nul, të paligjshme, pa asnjë vlerë ligjore, dhe për më tepër, me qëllime të dukshme dhe të qarta tashmë nga të gjithë, për të penguar zhvillimin e një procesi zgjedhor të ligjshëm dhe për të zgjedhur ato autoritete drejtuese dhe anëtarë të Senatit Akademik të UT, që vërtet e meritojnë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Për sa më sipër, do të kërkoja nga ana juaj të mos kryeni asnjë veprim bazuar në këto dokumenta, të paligjshme dhe në kundërshtim të plotë me Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, tashmë të miratuar, dhe të shpallur në adresën zyrtare të Universitetit të Tiranës [eëë.unitir.edu.al](http://eëë.unitir.edu.al).

Shumë shpejt, do tju përcillen dokumenta dhe shkresa zyrtare që kanë lidhje me procesin zgjedhor të ligjshëm që do të zhvillohet në Universitetin e Tiranës.

Duke ju falenderuar,

REKTORI  
PROF. DR. MËNYR KONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Nr. 491 Prot.

Tiranë, 26.01 2020

Lënda: Letër e hapur

**Drejtuar: Personelit akademik të Universitetit të Tiranës.**

**Të nderuar kolegë,**

Të gjithë e dimë që jemi në vitin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese të reja në Universitetin e Tiranës dhe besoj se të gjithë kanë mësuar se data 8 Maj 2020, është data e zgjedhjeve, në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë.

Sapo mësova se Urdhëri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në lidhje me zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, ishte shpallur në faqen zyrtare të MASR ( në datën 16 Janar 2020), pa pritur përcjelljen në rrugë zyrtare të tij nga MASR, në mënyrë të menjëhershme, në cilësinë e Kryetarit të Senatit Akademik, në datën 20 Janar 2020, njoftova zhvillimin e mbledhjes së Senatit Akademik, për ditën e enjte, datë 23 Janar 2020, ora 11:00, ku pika kryesore e rendit të ditës ishte pikërisht mbi Urdhërin e Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.8, datë 14.01.2020 "*Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë*".

Por, një ditë përpara datës së mbledhjes, nga asistentja ime mësova se disa nga anëtarët e Senatit Akademik, kishin kërkuar shtyrje të datës së mbledhjes, me justifikimin "*...se nuk është respektuar afati prej 7(shtatë) ditësh...*", i përcaktuar në Statutin e UT.

Kjo është sa qesharake, po aq edhe e paimagjinueshme, sidomos për çështjen në fjalë dhe rëndësinë që ka ajo.

**Së pari**, dua t'ju informoj se Senati Akademik i UT, si organ kolegji (shiko nenin 37, pika 1 të ligjit të arsimit të lartë 80/2015), funksionimin e tij e mbështet në ligjin nr.8480, datë 27.5.1999, "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*"; në ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe në nenin 32, pika 6 e Statutit të UT.

Në nenin 5 të ligjit nr.8480 datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*"; përcaktohet se: "*Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren nga kryetari, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj*".

**Së dyti**, në zbatim të nenit 131, pika 2 e ligjit të arsimit të lartë 80/2015, dhe të Statutit të UT, Senati Akademik i Universitetit i Tiranës, ka për detyrim ligjor hartimin dhe miratimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Rregullores së Zgjedhjeve dhe sipas pikës 3 të Urdhërit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.8, datë 14.01.2020 "*Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë*", Rregullorja e Zgjedhjeve e UT, duhet të jetë e miratuar 60(gjashtëdhjetë) ditë përpara datës së fillimit të procesit zgjedhor. Duke patur parasysh se data e fillimit të procesit zgjedhor, sipas pikës 1 të këtij Urdhëri, është data 9 Prill 2020, Rregullorja e Zgjedhjeve e UT, duhet të jetë hartuar dhe miratuar përpara datës 9 Shkurt 2020.

**Besoj se është shumë e kuptueshme nga të gjithë se sa emergjente dhe e domosdoshme ishte zhvillimi në ditën dhe në datën e caktuar të mbledhjes së Senatit Akademik të UT.**

Por një numër i caktuar senatorësh, konkretisht: nga Fakulteti i Drejtësisë: Artan Hoxha, Ilir Rusi, Skënder Kaçupi, Kestrin Katro; nga Fakulteti i Ekonomisë: Dhorë Kule, Sulo Hadëri, Shyqyri Llaci, Fatmir Memaj, Andrea Koxhaj; nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja: Artur Sula, Brikena Kadzadej; nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës: Anila Papparisto; nga Fakulteti i Shkencave Sociale: Edmond Rapti, Eliora Kulluri, Artemis Shehu, Theodhori Karaj si dhe 4 (katër) studentët senator, zgjedhën të mos vinin, duke bojkotuar në këtë mënyrë mbledhjen e Senatit Akademik; duke krijuar artifica dhe justifikime qesharake dhe aspak në dinjitetin e profesoratit dhe të rolit dhe të funksioneve që ka një anëtar i Senatit Akademik, sidomos kur bëhet fjalë për çështje kaq të rëndësishme, siç janë zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese të reja në Universitetin e Tiranës; si dhe, respektimin e afateve kohore për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Zgjedhjeve të UT, mbi bazën e të cilës, do të zhvillohen këto zgjedhje.

Bojkotimi i mbledhjes të Senatit Akademik nga senatorët e sipërcituar, bëri që të mos arrihej koourumi i nevojshëm dhe mbledhja e Senatit Akademik të mos zhvillohej, duke mos arritur të merrej asnjë vendim.

Të nderuar kolegë,

Në fakt, situata të tilla të ngjashme, fatkeqësisht kanë ndodhur edhe herë të tjera, dhe në të gjitha rastet, janë pothuajse të njëjtët senatorë të sipërcituar ata kanë zgjedhur të bojkotojnë mbledhjet, dhe bëhet fjalë për mbledhje në momente dhe ngjarje mjaft të rëndësishme për institucionin, duke u bërë shkaktarët kryesorë për vonesa në vendimarrje të caktuara apo në zvarritje në kohë për çështje mjaft të rëndësishme për UT.

Kështu, mund të përmendim:

- Mbledhja e datës 26 Tetor 2017, në të cilën ishte parashikuar miratimi i kandidaturës për Zv.Rektor të Universitetit të Tiranës; përzgjedhja e anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i Universitetit të Tiranës;
- Mbledhja e datës 12 Korrik 2018, në të cilën ishte parashikuar diskutimi dhe miratimi i Projekt statutit të UT;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

- Mbledhja e datës 13 Dhjetor 2018, në të cilën ishte parashikuar reflektimi dhe qëndrimi i Senatit Akademik ndaj konstatimeve të MASR për Statutin e UT;
- Mbledhja e datës 28 Mars 2019, në të cilën ishte parashikuar zgjedhja e anëtarëve të Komisioneve të përhershme në nivel institucioni ( si p.sh Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik); zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Etikës të UT.

Sikurse vihet re, në të gjitha rastet e sipërcituara, tematika e mbledhjes së Senatit Akademik, ka qenë mjaft e rëndësishme dhe shumë domethënëse për veprimtarinë normale të Universitetit të Tiranës, dhe, për të gjitha rastet, kërkohej vendimmarrja e Senatit Akademik, në zbatim të ligjit të arsimit të lartë 80/2015.

Por këta senatorë, zgjodhën të bojkotojnë mbledhjet, duke shkaktuar vonesa, me qëllim bllokimin e veprimtarisë së Universitetit të Tiranës dhe kryesisht të Rektorit të Universitetit të Tiranës.

Por sigurisht, në asnjë rast ata nuk ja kanë dalë.

Të nderuar kolegë,

Gjithkush nga ju mund të mendojë me të drejtë se përse dhe pse pikërisht tani, po ju bëj me dije mbi këtë situatë.

Në fakt, gjithmonë kam menduar se situata do të ndryshojë dhe kam shpresuar se profesorët që janë votuar dhe janë zgjedhur nga ana juaj për të kryer funksionet dhe rolin aq të rëndësishëm si anëtarë të Senatit Akademik të UT, do të fillonin ta kryenin atë.

Por tashmë, në përfundim të mandatit të këtij organi kolegjal, shpreh bindjen time të plotë se ata kanë shpërdoruar votën dhe besimin tuaj që i zgjodhët në këtë detyrë dhe kanë treguar një papërgjegjshmëri të plotë për realizimin e detyrës që kishin marrë përsëri për ta kryer.

Gjithashtu, zgjodha këtë moment për t'ju informuar, pasi edhe rëndësia e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Tiranës, është mjaft i rëndësishëm për institucionin.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, mbetem shpresëplotë në qëndrimin tuaj të drejtë dhe parimor; në qytetarinë dhe dinjitetin e secilit prej jush.

Rektori i Universitetit të Tiranës

Prof.Dr.Mynyr Koni



Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Rektorati e UT, Tiranë, Tel: +355 4 258447/Fax: +355 4 22 39 81